

**VENDIM**  
**Nr. 932, datë 18.11.2015**

**PËR PROCEDURËN PËR DHËNIEN E LICENCAVE TË IMPORTIT, EKSPORTIT  
DHE PRODHIMIT TË LËNDËVE PIROTEKNIKE DHE FISHEKZJARRËVE PËR  
PËRDORIM CIVIL**

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 100, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 7/1, të ligjit nr. 9126, datë 29.7.2003, “Për përdorimin civil të lëndëve plasëse, lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Licenca e importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike e të fishekzjarrëve për përdorim civil u jepet vetëm personave fizikë ose juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, nga Komisioni i Dhënies së Licencave, pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, në Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Miratimi ose refuzimi i vendimit për lëshimin e licencës së importit, eksportit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve, për përdorim civil, jepet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e aplikimit me shkrim të kërkuarit.
3. Licenca e prodhimit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil jepet brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e plotësimit të dokumentacionit.
4. Afati i vlefshmërisë së licencës për import dhe eksport të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil është 1-vjeçar, ndërsa afati i vlefshmërisë së licencës për prodhimin e lëndëve plasëse për përdorim civil është 5-vjeçar, me të drejtë rinovimi.
5. Personi fizik ose juridik, që kërkon të pajiset me licencë për import të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil, paraqet në Komisionin e Dhënies së Licencave kërkesë me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë, të shoqëruar me dokumentet origjinale ose fotokopjet e noterizuara, si më poshtë vijon:
  - a) Ekstraktin e plotë historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
  - b) Vërtetimin nga prokuroria, që shoqëria nuk është në procedim penal;
  - c) Kontratën ose urdhërporosinë me prodhuesin ose shpërndarësin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, e cila duhet të përfshijë një listë me lëndët që do të importohen, me numrin e kodit, emërtimin e këtyre lëndëve, mënyrën e paketimit, sasinë, peshën dhe vlerën financiare;
  - ç) Licencën për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit, të tipit “C”, me objekt magazinimin e lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil;
  - d) Aktin teknik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për mjediset ku do të magazinohen lëndët piroteknike/fishekzjarrët për përdorim civil;
  - dh) Autorizimin për magazinimin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;
  - e) Deklaratën për sasinë e mallit në magazinë, në momentin e aplikimit;
  - ë) Kontratën për ruajtjen e ambienteve të magazinimit me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike, ku të jenë parashikuar rregullat e ruajtjes e të sigurimit të objektit për magazinimin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve;
  - f) Mandatpagesën e tarifës së aplikimit.

6. Personi fizik/juridik i pajisur me licencë importi të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil duhet që:
  - a) për çdo parti malli të njoftojë, 7 (shtatë) ditë përpara mbërritjes së mallit, Komisionin e Dhënies së Licencave për sasinë që do të importojë;
  - b) të dërgojë pranë Komisionit të Dhënies së Licencave dokumentet e importit të lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e importimit të tyre në Republikën e Shqipërisë;
  - c) të dërgojë çdo fund viti në Komisionin e Dhënies së Licencave deklaratën vjetore, të shoqëruar me një pasqyrë për sasinë në gjendje të lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil.
  
7. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me licencë për eksport të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil, paraqet në Komisionin e Dhënies së Licencave kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë, të shoqëruar me dokumentet origjinale ose fotokopjet e noterizuara, si më poshtë vijon:
  - a) Ekstraktin e plotë historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
  - b) Vërtetimin nga prokuroria, që shoqëria nuk është në procedim penal;
  - c) Kontratën ose urdhërporosinë me importuesin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, e cila duhet të përfshijë një listë me lëndët që do të eksportohen, me numrin e kodit, emërtimin e këtyre lëndëve, mënyrën e paketimit, sasinë, peshën dhe vlerën financiare;
  - ç) Deklaratën nga përdoruesi i fundit lidhur me përdorimin e fundit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil;
  - d) Lejen për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit, të tipit “C”, me objekt magazinimin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil;
  - dh) Autorizimin për magazinimin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;
  - e) Aktin teknik për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin për mjediset ku janë magazinuar lëndët piroteknike/fishekzjarrët për përdorim civil;
  - ë) Mandatpagesën e tarifës së aplikimit.
  
8. Personi fizik/juridik i pajisur me licencë eksporti të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil duhet që:
  - a) për çdo parti malli të njoftojë, 7 (shtatë) ditë përpara nisjes së mallit, Komisionin e Dhënies së Licencave për sasinë që do të eksportojë;
  - b) të dërgojë pranë Komisionit të Dhënies së Licencave dokumentet e eksportit të lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e eksportimit të tyre nga Republika e Shqipërisë;
  - c) të dërgojë çdo fundvit në Komisionin e Dhënies së Licencave deklaratën vjetore, të shoqëruar me një pasqyrë për sasinë në gjendje të lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil.
  
9. Subjektet e interesuara për importimin ose eksportimin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, që shërbejnë për qëllime jotregtare, për qëllime licencimi, duhet të paraqesin pranë Komisionit të Dhënies së Licencave kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e sakte, të shoqëruar me dokumentet origjinale ose fotokopjet e noterizuara, si më poshtë vijon:
  - a) Ekstraktin e plotë historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
  - b) Vërtetimin nga prokuroria, që shoqëria nuk është në procedim penal;

- c) Kontratën ose urdhërporosinë me importuesin/eksportuesin e lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve për përdorim civil, e cila duhet të përfshijë një listë me lëndët që do të importohen ose do të eksportohen, me numrin e kodit, emërtimin e këtyre lëndëve, mënyrën e paketimit, sasinë, peshën, vlerën financiare;
  - ç) Deklaratën për qëllimin e importimit ose të eksportimit;
  - d) Mandatpagesën e tarifës së aplikimit.
10. Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve për përdorim civil, paraqet në Komisionin e Dhënies së Licencave kërkesën me shkrim, në formë autobiografike, me adresën e saktë, të shoqëruar me dokumentet origjinale ose fotokopjet e noterizuara, si më poshtë vijon:
- a) Ekstraktin e plotë historik nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit;
  - b) Vërtetimin nga prokuroria, që shoqëria nuk është në procedim penal;
  - c) Licencën për sigurinë dhe mbrojtjen e mjedisit, të tipit “C”, për ambientet e prodhimit e të magazinimit;
  - ç) Lejen e ndërtimit, shoqëruar me projektin e ndërtimit për prodhimin e lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve për përdorim civil;
  - d) Projektin teknologjik të prodhimit, i cili duhet të jetë i miratuar nga një inxhinier projektues i licencuar dhe me eksperiencë në projektimin e linjave teknologjike;
  - dh) Aktin teknik dhe projektin për mbrojtjen nga zjarri e shpëtimin për mjediset ku do të magazinohen dhe do të prodhohen lëndët piroteknike/fishekszjarrët për përdorim civil, ku të jenë përcaktuar sistemet e shuarjes nga zjarri si brenda dhe jashtë ambienteve të prodhimit e të magazinimit;
  - e) Kontratën e punësimit me drejtuesin teknik, i cili duhet të jetë inxhinier mekanik, kimist ose specialist prodhimi me përvojë 3-vjeçare në punë në fushën e prodhimit të lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve ose lëndëve plasëse për përdorim civil, i cili ka përgjegjësinë ligjore për zbatimin dhe respektimin e rregullores së sigurimit teknik të procesit të prodhimit e të magazinimit, si dhe për trajnimin e punonjësve për masat e sigurisë në punë, sigurinë e prodhimit dhe sigurinë e magazinimit;
  - ë) Planveprimin dhe dokumentacionin për kushtet e sigurisë në punë, trajnimin e punonjësve e të stafit, të miratuar nga drejtuesi teknik;
  - f) Kontratën për ruajtjen e ambienteve të prodhimit e të magazinimit me një shoqëri të licencuar për shërbimin privat të sigurisë fizike, ku të jenë parashikuar rregullat e ruajtjes e të sigurimit të objektit për magazinimin e lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve;
  - g) Autorizimin për magazinimin e lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve për përdorim civil, lëshuar nga ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;
  - gj) Mandatpagesën e tarifës.

Subjekti i interesuar, që kërkon të pajiset me licencë për prodhimin e lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve për përdorim civil, për produktet të cilat kërkon të prodhojë duhet të kryejë, pranë një laboratorit të akredituar, procedurat e vlerësimit të konformitetit të lëndëve piroteknike/fishekszjarrëve, duke ndjekur njërin nga procedurat e mëposhtme:

- a) Ekzaminimin e tipit EC (moduli B) dhe, sipas zgjedhjes së prodhuesit, njërin prej procedurave të mëposhtme:
  - i. konformitetin ndaj tipit (moduli C);
  - ii. sigurimin e cilësisë së produktit (moduli D);
  - iii. sigurinë e cilësisë së produktit (moduli E).
- b) Vlerësimin e produktit (MODULI G);

c) Sigurinë e plotë të cilësisë së produktit (MODULI H).

Për çdo ndryshim që mund të bëjë subjekti gjatë aplikimit apo pas marrjes së licencës në kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë vendim, duhet të njoftojë, brenda 10 (dhjetë) ditësh pune, Komisionin e Dhënies së Licencave.

11. Pas plotësimit të kriterëve të përgjithshme të licencimit të prodhimit, sipas pikës 10, të këtij vendimi, Komisioni i Dhënies së Licencave, me qëllim kryerjen e procedurave të vlerësimit të konformitetit, merr vendim për të lejuar prodhimin vetëm për nevoja testimi, deri në pajisjen nga një laborator i akredituar me njërën nga certifikatat e konformitetit, sipas përcaktimeve në modulet e sipërpërmendura.
12. Mandatpagesa e tarifës përkatëse paraqitet nga subjekti tregtar pas marrjes së vendimit nga Komisioni i Dhënies së Licencave dhe para zbardhjes së licencës.
13. Personi fizik/juridik i pajisur me licencë prodhimi duhet të raportojë pranë Komisionit të Dhënies së Licencave për:
  - a) sasinë e mallit të prodhuar, çdo fund muaji;
  - b) sasinë e mallit të prodhuar, shitjet, harxhimet, eksportet e shoqëruara me fatura shitjeje apo deklarata doganore, brenda datës 15 dhjetor, të çdo fund viti.
14. Komisioni i Dhënies së Licencave, brenda fushës së veprimtarisë së tij, ka të drejtë të kryejë kontrolle dhe verifikime, rast pas rasti, në pikat doganore për importin e lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil, në depot e magazinimit dhe në linjat e prodhimit.
15. Prodhuesi dhe importuesi i lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve duhet të sigurohet që këto produkte të jenë të etiketuara në mënyrë të dukshme në gjuhën shqipe. Etiketimi duhet të përfshijë minimalisht emrin dhe adresën e prodhuesit ose të importuesit në rastet e importit, emrin dhe llojin e artikullit, moshën minimale të lejuar për përdorim, kategorinë e lëndëve, mënyrën e përdorimit, vitin e prodhimit dhe sasinë neto të materialit eksploziv në lëndët piroteknike/fishekzjarrët për përdorim civil, si dhe kur është e nevojshme, distancën minimale të sigurisë.
16. Dokumentacioni ligjor i paraqitur nga subjektet, të cilat aplikojnë për licenca importi/eksporti/prodhimi, duhet të jetë lëshuar nga organet kompetente, brenda tre muajve të fundit nga data e aplikimit të subjektit. Për dokumentacionin, i cili lëshohet me afat të caktuar vlefshmërie, subjekti pas marrjes së licencës, ka detyrimin e rinovimit të tij dhe paraqitjen para Komisionit të Dhënies së Licencave, brenda 5 (pesë) ditësh pune nga data e mbarimit të afatit të vlefshmërisë.
17. Nëse Komisioni i Dhënies së Licencave, gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, konstaton se pas pajisjes me licencë subjekti humbet ose ndryshon kushtet dhe kriteret e përcaktuara për dhënien e licencës, mund të vendosë për pezullimin e licencës.
18. Nëse Komisioni i Dhënies së Licencave, gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara, konstaton se pas pajisjes me licencë subjekti ka kryer shkelje të detyrimeve të përcaktuara në pika 6, 8, 13 dhe 15, këtij vendimi, pas një njoftimi paralajmërues drejtuar subjektit, mund të vendosë për pezullimin e licencës.
19. Në rastet e pezullimit të licencës, subjektit i jepet një afat kohor nga një deri në tre muaj për plotësimin e mangësive të konstatuara. Në përfundim të këtij afati, në rast të

mosplotësimin të mangësive, Komisioni i Dhënies së Licencave vendos për heqjen e licencës.

20. Komisioni i Dhënies së Licencave mund të vendosë heqjen e licencës subjektit edhe në rast se:
  - a) gjatë verifikimeve dhe kontrolleve të ushtruara konstaton përsëritjen e shkeljeve të përcaktuara në pikat 17 dhe 18, të këtij vendimi;
  - b) subjekti dënohet me vendim gjykate të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me ushtrimin e veprimtarisë së importimit, eksportimit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil apo që cenon jetën e shëndetin e njeriut;
  - c) subjekti gjatë importimit, eksportimit apo prodhimit të lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve për përdorim civil shkel rregullat teknike të prodhimit, transportimit, përdorimit dhe konformitetit të lëndëve piroteknike/fishekzjarrëve, duke rrezikuar jetën e njerëzve, kafshëve dhe/ose mjedisit.
21. Vendimet e Komisionit të Dhënies së Licencave mund të ankimohen te ministri i Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.
22. Ministri i Mbrojtjes, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së ankimit, vendos për lënien në fuqi, ndryshimin ose shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Dhënies së Licencave.
23. Ndaj vendimit të ministrit të Mbrojtjes mund të bëhet ankim në rrugë gjyqësore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes dijeni.
24. Tarifat financiare për dhënien e licencave të importit, eksportit apo prodhimit të lëndëve piroteknike dhe fishekzjarrëve për përdorim civil përcaktohen me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.
25. Vendimi nr. 853, datë 17.12.2004, i Këshillit të Ministrave, “Për procedurën e dhënies së licencës së importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve piroteknike, fishekzjarrë, për përdorim civil”, shfuqizohet.
26. Ngarkohen Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**